

BASHKIMI EVROPIAN - KOSOVA
TAKIMI I 5-TË I NËN-KOMITETI PËR TREGUN E BRENDSHËM,
KONKURRENCËN, SHËNDETIN DHE MBROJTJEN E KONSUMATORIT
BRUKSEL (TAKIM VIRTUAL), 3 SHKURT 2021
KONKLuzionet e Përbashkëta

KONKLuzionet

KONKURRENCA

1. Të sigurohet harmonizimi i vazhdueshëm i legjislacionit të konkurrencës të Kosovës me *acquis* të BE-së, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian;
2. Të forcohen kapacitetet administrative të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për kryerjen e hetimeve;
3. Të rritet bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe organeve të tjera rregullatore;
4. Të vazhdohet ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e politikave të konkurrencës në mesin e stafit dhe palëve përkatëse, me theks të veçantë tek gjyqtarët, përmes masave të trajnimit dhe avokimit;
5. Të ndërmerren hapa për të siguruar që parimet e përcaktuara në TFBE zbatohen për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive, para datës 1 prill 2019, sipas dispozitave të Nenit 76 të MSA-së (TM4 2021);
6. Legjislacioni për homologimin e automjeteve (Udhëzimi Administrativ Nr. 2/2018, Ligji për Automjete në nëntor 2020) duhet të rishikohet, në mënyrë që të përafrohet me Opinionin Profesional të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, praktikatat më të mira të BE-së dhe të eliminohen barrierat jo-tarifore.

Ndihma shtetërore

1. Të ndërmerren hapa për të siguruar që inventari i skemave të ndihmës të mbahet i përditësuar dhe i përafruar me MSA-në;
2. Të zhvillohet tutje hartëzimi i inventarit të ndihmës shtetërore dhe të organizohet shqyrtimi i të gjitha skemave të mundshme (TM4 2021);
3. Të harmonizohen skemat që janë vlerësuar me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore (TM4 2021);
4. Të ndiqen rastet dhe të vazhdohet implementimi i kontrollit të ndihmës shtetërore;
5. Të vazhdohet forcimi i kapaciteteve dhe buxhetit të Departamentit të Ndihmës Shtetërore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Ndihmën Shtetërore (TM3 2021);

6. Të miratohet legjislacioni dytësor, Rregullorja për Ndhimën Rajonale si dhe Rregullorja për Ndhimën Horizontale, Shërbimet me Interes të Përgjithshëm Ekonomik (TM3 2021);
7. Të mbahet Komisioni i informuar mbi zhvillimet në lidhje me termocentralin e mundshëm të qymyrit Kosova e Re (TM3 2021);
8. Të futen programe të trajnimit profesional për personelin e ndihmës shtetërore dhe personelin në institucionet dhënëse të ndihmës, prokurorinë dhe gjykatat (TM4 2021);
9. Të vazhdohet ndërgjegjësimi lidhur me rregullat e ndihmës shtetërore ndërmjet dhënësve të ndihmës dhe të rriten përpjekjet për avokim;
10. Të krijohet një platformë efektive për bashkëpunim ndërmjet Komisionit të Ndhimës Shtetërore dhe Departamentit të Ndhimës Shtetërore si dhe dhënësve të ndihmës, me qëllim të përmbushjes së duhur të detyrimeve që burojnë nga MSA për ndihmën shtetërore (TM4 2021);
11. Të ketë angazhim të mëtutjeshëm me ministrinë dhe rregullatorët e sektorit në lidhje me shkëmbimin e informacionit mbi skemat mbështetëse.

PROKURIMI PUBLIK

1. Të sigurohet që Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit të ketë stafin e duhur dhe operacional duke finalizuar procesin për emërimin e anëtarëve të bordit (TM3 2021);
2. Të vlerësohet implementimi i Strategjisë aktuale Kombëtare të Prokurimit, si pjesë e përgatitjes për një strategji për periudhën pas vitit 2021 dhe Plani i Veprimit për implementimin e saj (TM3 2021);
3. Të konsultohet projektligji për Partneritetet Publiko-Private, të përafruar me Direktivën 2014/23/EU, me SIGMA dhe Komisionin Evropian (TM2 2021), duke përfshirë përjashtimin e bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare, dhe të sigurohet qasje në sistemin e rishikimit dhe të miratohet i njëjti (TM4 2021);
4. Të hartohet legjislacioni dytësor i përafruar me projektligjin e ri për PPP (TM4 2021);
5. Të miratohet Ligji për Prokurimin Publik (TM3 2021);
6. Të hartohet legjislacioni sekondar i përafruar me ligjin për PP (TM1 2022);
7. Të përmirësohet tutje zhvillimi i kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit dhe operatorëve ekonomikë për përdorimin platformës e-prokurimi, përfshirë skemat e trajnimit dhe udhëzimet për autoritetet kontraktuese, për të inkurajuar përdorimin e ‘kriterit ekonomikisht më të favorshëm’ bazuar në konceptin e ‘raportit më të mirë çmim-cilësi’ (TM4 2021);
8. Të përmirësohet tutje koordinimi, duke përfshirë krijimin e mekanizmit të bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet palëve të interesit në prokurimin publik p.sh. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Agjencia Qendrore e Prokurimit, por edhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Auditori i Përgjithshëm, gjyqësori dhe organet e rendit (TM4 2021);
9. Të krijohen rregullore dhe udhëzime për hulumtimin e tregut si pjesë e vlerësimit të centralizuar të prokurimit publik para dhënies (TM3 2021);

10. Të vazhdohet me zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik duke përfshirë menaxhimin e kontratës dhe modulet e performancës së kontraktorëve (TM1 2021);
11. Të adresohen gjetjet e raportit të auditimit të performancës të kryer në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (TM4 2021).

SHËRBIMET

1. Të vazhdohen përgatitjet për krijimin e Pikës së Vetme të Kontaktit, përfshirë burimet njerëzore dhe TI-në (TM4 2021);
2. Të dorëzohet raporti për zbatimin e legjislacionit për shërbimet në Kosovë për vitet 2018-2020 (TM4 2021);
3. Të krijohet një mekanizëm monitorimi për të përcjellë implementimin e Planit pesëvjeçar të Veprimit (TM3 2021);
4. Të vazhdohet procesi i përafrimit të legjislacionit kombëtar me Direktivën e Shërbimeve (TM4 2021);
5. Të rriten kapacitetet profesionale të departamenteve ligjore dhe tregtare të MTI-së për vlerësimin e përputhshmërisë së draft akteve normative me Ligjin për Shërbimet. (TM4 2021);
6. Të ratifikohet Protokollin shtesë 6 i CEFTA-s për Shërbimet (TM3 2021);
7. Të organizohet ngritja e ndërgjegjësimit të bizneseve, shoqatave profesionale dhe komunave mbi thjeshtimin e procedurave administrative të lidhura me zbatimin e Planit Pesëvjeçar të Veprimit (TM4 2021);
8. Të miratohet dhe implementohet Ligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike (TM3 2021);
9. Të hartohet dhe miratohet Ligji për Tregtinë Elektronike duke marrë parasysh rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian (TM4 2021).

Shërbimet postare

1. Të vazhdohet përafrimi me *acquis* për shërbimet postare, përfshirë rregulloren për shërbimet e shpërndarjes ndërkufitare të dërgesave (TM4 2022);
2. Të adresohet zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve që merren me shërbimet postare për të siguruar proces të suksesshëm të shqyrtimit dhe përafrimit (TM4 2021);
3. Të zhvillohet dhe miratohet baza legjislative për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove neto të shërbimit universal postar (TM3 2021).

Kualifikimet profesionale

1. Të miratohet legjislacioni dytësor për zbatimin e Ligjit për Profesionet e Rregulluara (TM4 2021);
2. Të krijohet një listë e detajuar e profesioneve të rregulluara që përmbajnë grupin e profesioneve, specialiteteve, seksionet e Direktivës së BE-së në lidhje me këtë grup profesionesh, ligjet që lidhen me këtë grup profesionesh, nëse ka të tilla, Organizatat që lidhen me këtë grup profesionesh: organet e informacionit, organet e ekzaminimit, ministritë përgjegjëse, autoritetet kompetente. (TM4 2021);
3. Të shqyrtohen kërkesat për qasje në secilin profesion të rregulluar në Kosovë, duke përdorur Direktivën 2018/958 për testin e proporcionalitetit si mjet ndihmës gjatë vlerësimit të kërkesave (TM4 2022);
4. Për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të profesionistëve dhe shërbimeve, të vendosen strukturat, rregullat dhe procedurat e nevojshme për njohjen e kualifikimeve profesionale të marra në vende të tjera (TM3 2021).

TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të

1. Të ndërmerren hapat për tu harmonizuar më tej me *acquis*, veçanërisht në lidhje me legjislacionin më të fundit të BE-së për të drejtën e autorit, siç është Direktiva për Menaxhimin e të Drejtave Kolektive. (TM4 2021);
2. Të vazhdohen përpjekjet për garantimin e zbatimit të marrëveshjeve të përshtatshme të licencimit kolektiv në mënyrë që të garantohet kompensimi për mbajtësit e të drejtave (TM4 2021).

Të drejtat e Pronësisë Industriale

1. Të ndërmerren hapat për t'u harmonizuar tutje me *acquis*, veçanërisht në lidhje me markat tregtare, sekretet tregtare, patentat dhe dizajnin industrial – të rishikohet dhe ndryshohet Ligji për Patentat, Ligji për Topografitë e Qarqeve të Integruara dhe Ligji për Dizajnin Industrial dhe të hartohet dhe miratohet Ligji për Markat Tregtare dhe Ligji për Sekretet Tregtare (TM3 2021);
2. Të përgatitet dhe miratohet dokumenti Strategjik i Pronësisë Industriale me afat kohor dhe plan veprimi të qartë (TM4 2021);
3. Të sigurohet implementimi dhe aplikimi efektiv i Direktivës për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Industriale (TM3 2021);
4. Të ndërmerren hapa konkretë për të rritur kapacitetin dhe koordinimin e institucioneve politikëbërëse dhe organeve të rendit - në veçanti efektivitetin e Task Forcës dhe Këshillit

Shtetëror të PI-së - për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare dhe për të luftuar mallrat e falsifikuara dhe piraterinë. Të përgatiten raporte të përbashkëta të aktiviteteve (TM4 2021);

5. Të rriten kapacitetet administrative dhe profesionale të Agjencisë së Pronësisë Industriale (TM4 2021);
6. Të rritet ndërgjegjësimi për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, duke kontribuar në rritjen e numrit të aplikimeve për pronësinë intelektuale;
7. Të rritet ndërgjegjësimi i bartësve të të drejtave për të kërkuar mbrojtje ligjore, duke rritur numrin e kërkesave për veprime në organet e rendit.

MBROJTJA E KONSUMATORIT

1. Të ndryshohet ligji për mbrojtjen e konsumatorit në atë mënyrë që të hiqen elementet e diskutueshme dhe të metat teknike (TM 2021);
2. Të miratohet Rregullorja e ndryshuar për organizimin e brendshëm të MTI-së përfshirë strukturën ligjore të autoriteteve për mbrojtjen e konsumatorit (TM4 2021);
3. Të përafrohet tutje ligji për mbrojtjen e konsumatorit me *acquis* përkatës, përfshirë rishikimin e nenit 10.5 të ligjit aktual sipas dispozitave të Direktivës 2005/29/EC (TM1 2022);
4. Të vazhdoen dhe përditësohen aktivitetet e tjera ndërgjegjësuese me palët e interesit mbi të drejtat e konsumatorëve dhe detyrimet e tregtarëve, veçanërisht në lidhje me blerjen online (2021, vazhdimisht gjatë gjithë vitit);
5. Të përgatitet Ligji i ri për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve – të miratohet Koncept Dokumenti (TM2 2021) dhe të përgatitet projektligji (TM1 2022);
6. Të hartohet dhe miratohet Programi i ri i Mbrojtjes së Konsumatorit 2021-2026 (TM2 2021);
7. Të rriten kapacitetet e burimeve njerëzore të MTI-së, me theks të veçantë tek inspektorët për mbrojtje më të mirë të konsumatorëve.

MBROJTJA E SHËNDETIT

1. Të miratohet Ligji i ndryshuar për Shëndetësi (TM3 2021);
2. Të miratohet Ligji i ndryshuar për Sigurimin Shëndetësor (TM3 2021);
3. Të fillohet implementimi i masave për promovimin dhe edukimin shëndetësor (TM3 2021);
4. Të implementohet legjislacioni ekzistues dhe Plani i Veprimit për kontrollin e duhanit (TM1 2022) dhe të raportohet progresi deri në TM3 2022;
5. Të vendosen masa për të siguruar shërbime adekuate të kujdesit shëndetësor parësor dhe sigurimit të detyrueshëm shëndetësor dhe të miratohen masa të mëtjshme për të përmirësuar

standardet e cilësisë në kujdesin shëndetësor, përfshirë investimet në aktivitetet dhe trajnimin e promovimit të shëndetit (2021);

6. Të bëhet progres në përgatitjen e pakos së përfitimeve bazë dhe të mbahen konsultimeve publike dhe ndërgjegjësim, para fillimit të mbledhjes së premieeve për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (TM1 2021);
7. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të kërkojë këshilla teknike nga BE-ja për të përgatitur studimin e vlerësimit të ndikimit në shëndet mbi ndotjen e ajrit (TM3 2021);
8. Të miratohet dhe implementohet Plani i Veprimit për sëmundjet ngjitëse bazuar në rekomandimet e raportit të vlerësimit teknik të ECDC (TM3 2021);
9. Të vazhdoen përpjekjet për përmirësimin e nivelit të kapaciteteve për sistemin e mikrobiologjisë së shëndetit publik sipas gjetjeve të anketës ENLabCap.

LIGJI PËR KOMPANITË

1. Të përafrohen zhvillimet e ardhshme të legjislacionit të Ligjit për Kompanitë me Direktivën EU/2017/1132 (kodifikim), dhe dispozita të tjera të BE-së në fushat ku ka pasur boshllëqe ose përafrim të pjesshëm në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke përfshirë kërkesat minimale për kapital, aspektet e zbulimit të informacionit në lidhje me kompanitë dhe degët e tyre, bashkimet ndërkufitare, mbrojtja e aksionarëve dhe ofertat për blerje (TM4 2022). Të ofrohet afati kohor për punën e mbetur të përafrimit (TM1 2021);
2. Të ofrohen informacione në lidhje me punën e planifikuar dhe afatin kohor për tu përafuar me *acquis* më të fundit të BE-së (Direktiva 2017/828, Direktiva 2019/1151 dhe Direktiva 2019/2121) (TM2 2021);
3. Të miratohet Kodi i Qeverisjes së Korporatës (TM2 2021);
4. Të implementohen aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare (TM4 2021);
5. Të sigurohet që kushtet për lidhjen e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me infrastrukturën teknike të Sistemit të Ndërlidhjes së Regjistrave të Bizneseve janë përmbushur (TM4 2021);
6. Të forcohen kapacitetet administrative të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Ekonomisë mbi legjislacionin e Ligjit për Kompanitë. (TM4 2021);
7. ARBK të krijojë kornizë bashkëpunimi me Këshillin e Kosovës për Raportimin Financiar dhe Administratën Tatimore për të siguruar përditësimin e vazhdueshëm të informacionit të kompanive (TM3 2021).
8. ARBK të publikojë informacionin e kompanive duke përfshirë pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit duke çuar kështu në rritjen e transparencës, rritjen e besueshmërisë së regjistrimit të të dhënave. (TM1 2021);
9. Të sigurohen burimet adekuate për të ushtruar kompetenca mbikëqyrëse, për të kryer inspektime për mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë të shoqatave profesionale, firmave të

auditimit dhe auditorëve ligjorë dhe për funksionalizimin e softuerit për marrjen dhe përpunimin e pasqyrave financiare (TM4 2021).

LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

1. Të sigurohet që janë ndërmarrë hapat e duhur për t'u dhënë trajtim kombëtar shtetasve të BE-së dhe për t'i lejuar ata të blejnë, përdorin dhe shkëmbejnë prona në Kosovë në përputhje me MSA-në dhe të nxirret legjislacioni i nevojshëm brenda afatit kontraktual të MSA-së të vitit 2021 (TM3 2021);
2. Të përfundohet transpozimi i Direktivës së Shërbimit të Pagesave 2;
3. Të miratohet Koncept Dokumenti për shpëlarjen e parave (TM3 2021);
4. Të përmirësohet ndjeshëm ndërgjegjësimi për rreziqet e shpëlarjes së parave/financimit të terrorizmit nga bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare dhe të sigurohen dëshmi përmes të dhënave mbi raportet e transaksioneve të dyshimta të marra dhe nga ndjekja ligjore përmes hetimeve dhe sanksioneve nga ana e autoriteteve;
5. Të trajtohet në mënyrë efikase çështja e identifikimit të pronarëve përfitues dhe të krijohet regjistri i Pronësisë Përfituese, përfshirë ndërgjegjësimin që synon promovimin e të kuptuarit të pronësisë përfituese përtej mbajtjes direkte të 25% ose më shumë aksioneve në një kompani.

SHËRBIMET FINANCIARE

1. Të zbatohen në mënyrë të plotë masat e Aftësisë Paguese 1 dhe të vazhdohet zbatimi i udhërrëfyesit për transpozimin e ardhshëm të Aftësisë Paguese 2;
2. Të synohet përafrimi me kornizën e Bazelit;
3. Të miratohet Ligji për Bankat (TM4 2021);
4. Të miratohet Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare, duke marrë parasysh komentet e Komisionit Evropian (TM4 2021);
5. Të themelohet një funksioni i pavarur zgjidhjeje brenda Bankës Qendrore të Kosovës (TM1 2022);
6. Të vazhdohet rritja e rolit mbikëqyrës dhe vëzhgues i Bankës Qendrore në industrinë e sigurimeve.